

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

LIGJET DHE TATIMET NË KOSOVË

Zgjidhjet

P4

Nr.

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Udhëzime/Instructions:

1. MOS E HAPNI DERISA T'IU LEJOHET PREJ
MBIKËQYRËSIT
Do Not Open Until Your Invigilator Allows You to Do So.
2. ËSHTË E DETYRUESHME PËRGJIGJA E GJITHA
PYETJEVE
All Questions Are Mandatory
3. KOHA E LEJUAR ËSHTË 3 ORË
Time Allowed is 3 Hours
4. EMRI JUAJ NUK DUHET TË PARAQITET NË ASNJË
FLETË TË KËTIJ PROVIMI.
Your name should appear nowhere in this test.

Data 19.12.2020

CONTENT / PËRMBAJTJA

Pjesa	Maksimumi i Dhënë	<u>-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga ShKÇAK-PIKËT E DHËNA</u>
A. Zgjidhje shumëfishe	20	
B. Zgjidhje opcionale	20	
1. Problemi 1	15	
2. Problemi 2	10	
3. Problemi 3	10	
4. Problemi 4	10	
5. Problemi 5	7	
6. Problemi 6	8	
Total	100	

1. Nëse Qeveria e Kosovës si pjesë e politikës për rimëkëmbje ekonomike për shkak të pandemisë me virusin COVID-19, ka vendosur që për sektorin e gastronomisë të aplikohet norma e Tvsh-së prej 8% në vend të 18% për të gjitha produktet dhe shërbimet. Nëse sektori i gastronomisë çmimin shitës të kafes prej 1.00 Euro përfshirë Tvsh, pas këtij vendimi nuk e ndryshon çmimin shitës, atëherë sa do të jetë përfitimi shtesë bruto në përqindje për sektorin e gastronomisë nga kjo masë :
 - a) 10.00%;
 - b) 9.26%;**
 - c) 9.00%;
 - d) 8.47%.

2. Kompania "FLATRA" ka importuar 5,500 njësi të produktit "X" për rishitje (mall) nga Gjermania. Vlera e faturës në total nga kompania gjermane është 8,000 Euro. Kosto e transportit nga Gjermania në Kosove është 2,000 Euro. Autoritet doganore kanë bërë rivlerësim faturës së mallit për të cilën kanë vendosur bazën doganore në vlerë prej 11,000 Euro (pra rivlerësim prej 3,000 Euro). Poashtu sipas kalkulimeve në Dokumentin Unik Doganor (DUD) këto mallra i nënshtrohet normës prej 10% taksë doganore dhe 18% Tvsh. Kompania "FLATRA" e ka pranuar bazën e paraqitur nga Dogana. Sa do të jetë kosto e blerjes për njësi për produktin X për kompaninë importuese "FLATRA"?
 - a) 1.96 Euro;
 - b) 2.05 Euro;**
 - c) 2.56 Euro;
 - d) 2.60 Euro;

3. Blend Krasniqi në muajin Nëntor 2020 ka pasur rrogën Bruto (primare) prej 850.00 Euro. Në Dhjetor të vitit 2020, menaxhmenti i kompanisë ku ai është i punësuar vendosi që paga e Blendit të zvogëlohet për Neto vlerë prej 100.00 Euro. Sa do të jetë paga NETO në Dhjetor të vitit 2020 për Blendin?
 - a) 648.95 Euro;**
 - b) 658.23 Euro;
 - c) 663.45 Euro;
 - d) 750.00 Euro.

4. Qiradhënësi "BEHARI" shpk, një biznes tregtar nga Prizreni, lëshon faturën për një pasuri në baza mujore qiramarrësit "ALBANI" shpk. Qiraja sipas kontratës është 9,600 neto. Sa duhet të **pagujë** qiramarrësi "ALBANI" shpk për këtë faturë Qiradhënësit. Fatura është subjekt i tatimit të qirasë dhe Tvsh-së sipas normës së aplikueshme të ligjeve në Kosovë.
- 10,308.48 Euro;
 - 10,549.45 Euro;
 - 11,498.90 Euro;**
 - 12,448.35 Euro.
5. Kompania "ABC", në Tetor 2020 ka pranuar një notë debitoare të lëshuar nga kompania "CBA" për blerjet të cilat i ka bërë "ABC" para dy muajve nga kjo e fundit. Nota debitoare e lëshuar nga "CBA" është në vlerë 7,654.32+Tvsh 18%. Për kompaninë "CBA" kjo notë ka ndikim që:
- rrit Tvsh e zbritshme;
 - rrit Tvsh e llogaritur;**
 - zvogëlon Tvsh e zbritshme;
 - zvogëlon Tvsh e llogaritur.
6. Fature në vlerë totale prej 1,000.00 Euro (përfshirë Tvsh) është kalkuluar gabimisht me Tvsh prej 8% duhet te korigjohet me normën standarde. Në të njëjtën ditë është kthyer edhe një pjesë e mallit në këtë faturë i cili kthim poashtu duhet rregulluar në këtë faturë. Malli i kthyer ka pasur kosto 100.00 Euro. Sa duhet të jetë vlera e faturës përfshirë Tvsh me norme standarde 18% pas korigjimit?
- 900.00 Euro;
 - 974.59 Euro;**
 - 983.32 Euro;
 - 1,062.00 Euro.
7. Biznesi CBA shpk veprimtaria afariste e të cilit është dhënia me qera e automjetëve, e cila për qëllime tatimore është biznes i regjistruar si Korporatë e Madhe me Tvsh, si duhet të deklarojë tatimin e të hyrave nga qeraja në baza tremujore ky biznes?
- Shërbyese me 9%;
 - Tregtare me 3%;
 - Normë standarde 18% apo të reduktuar 8%;
 - Tatim në fitim 10%;**
 - Asnjëra më lartë.

8. Një tatimpagues (shpk) që të tatimohet në baza reale dhe që ai tatimpagues të konsiderohet person i tatueshëm për Tvsh, (përveq nëse regjistrohet vullnetarisht) duhet të arrijë përkatësisht të kalojë pragun e të ardhurave vjetore prej :
- a) 30,000 Euro për taturje në baza reale dhe 50,000 Euro për tu regjistruar në Tvsh;
 - b) 50,000 Euro për taturje në baza reale dhe 50,000 Euro për tu regjistruar në Tvsh;
 - c) 50,000 Euro për taturje në baza reale dhe 30,000 Euro për tu regjistruar në Tvsh;
 - d) 30,000 Euro për taturje në baza reale dhe 30,000 Euro për tu regjistruar në Tvsh;
 - e) Asnjëra më lartë.
9. Kompania "JON" është biznes i cili tatohet sipas skemës reale dhe përbëhet nga 3 ortakë (Joni, Olta dhe Noari) pra biznes ortakëri. Sipas legjislacionit tatimor ortakëria dhe ortakët për periudhën që përfundon me 31.12.2020 duhet të deklarojnë pranë ATK-se:
- a) Ortakëria deklaratën DO ndërsa ortakët se bashku një deklaratë të PD-së;
 - b) Ortakëria deklaron PD ndërsa ortakët secili DO;
 - c) Ortakëria deklaron DO ndërsa secili ortak deklaratën e PD-së;
 - d) Ortakëria deklaron DO ndërsa ortakët nuk kanë obligim për deklarim;
 - e) Asnjëra më lartë.
10. Për qëllime tatimore për vlerësimin e stokeve dhe njohjen e KMSH në fund të vitit cila metodë lejohet për trajtimin e stokeve?
- a) metoda LIFO;
 - b) metoda FIFO;
 - c) metoda NIFO;
 - d) Asnjëra më lartë.

1. Sipas ligjit nr. 06/L-016 për "Shoqëritë tregtare", dividendët mund t'i paguhen Aksionarëve nga fitimi neto ose nga fitimi i ruajtur nga vitet e kaluara, prej të cilit janë zbritur humbjet nga vitet e kaluara, në bazë të raportit vjetor të miratuar.

E saktë

E pasaktë

2. Sipas ligjit nr. 06/L-016 për "Shoqëritë tregtare", përveç nëse është përcaktuar ndryshe në Statutin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, çdo Aksionar mund të bëjë bartjen e aksionit të tij, plotësisht ose pjesërisht përmes shitjes, pengut, dhurimit, trashëgimisë ose ndonjë forme tjetër të bartjes.

E saktë

E pasaktë

3. Sipas ligjit nr. 06/L-016 për "Shoqëritë tregtare", përveç nëse është përcaktuar ndryshe në Statutin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, drejtori menaxhues shkarkohet me votën e aksionarëve ose Bordit të Drejtorëve. Aksionarët apo Bordi i Drejtorëve duhet të deklarojnë arsyen për shkarkimin e tij, dhe personi i shkarkuar ka të drejtë të kërkojë nga Aksionarët ose Bordi i Drejtorëve arsyen për shkarkimin e tij/saj.

E saktë

E pasaktë

4. Sipas ligjit nr. 06/L-032 për "Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim", raporti i auditimit nënshkruhet nga auditori ligjor, ku firmoset edhe data e nënshkrimit. Kur një firmë auditimi kryen auditimin, raporti i auditimit nënshkruhet nga personi i autorizuar/përfaqësuesi ligjor i firmës ligjore që kryen auditimin në emër të firmës së auditimit;

E saktë

E pasaktë

5. Sipas ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat, çdo transaksion mbi një mijë e pesëqind (1,500) euro, i bërë në mes të personave të përfshirë në aktivitet ekonomik, pas 1 janarit të vitit 2009 kërkohet të bëhet përmes llogarisë bankare.

E saktë

E pasaktë

6. Sipas ligjit nr. 06/L-032 për “Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim”, Shoqëritë tregtare në Kosovë sipas nenit 5, paragrafët 5., 10. dhe 11. të këtij Ligji emërojnë një auditor apo një firmë të auditimit për angazhim fillestar të paktën për një vit. Angazhimi mund të rinovohet. As angazhimi fillestar i një auditori ligjor apo firme të auditimit, e as ky kombinim me ndonjë angazhim të përtërirë nuk duhet të tejkalojë kohëzgjatjen maksimale prej pesë (5) vitesh.

E saktë

E pasaktë

7. Sipas ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat, çdo tatimpagues pa marrë parasysh qarkullimin vjetor, përveç mbajtjes së librave dhe regjistrimeve të parapara me ligj, kërkohet të bëjë dhe mbajë regjistrimin e mallrave në stoqe në fund të vitit kalendarik. Regjistrimet e parapara sipas këtij paragrafi duhet të jenë të gatshme më apo para 10 janarit të vitit vijues si dhe mallrat që posedon tatimpaguesi duhet të dokumentohen me dokumente mbi origjinën.

E saktë

E pasaktë

8. Sipas ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat, kur një person i angazhuar në aktivitet ekonomik posedon mallra pa origjinë ai person do t'i nënshtrohet ndëshkimit administrative me njëzetepesë përqind (25%) të vlerës së tregut së mallrave. Ato mallra mund të merren dhe të mbahen në kujdestari të ATK-së me qëllim të caktimit të detyrimit penal.

E saktë

E pasaktë

9. Blerjet për të cilat një faturë është lëshuar duhet të futet në librin e blerjeve brenda 3 ditëve pas pranimit të faturës së blerjes. Shitjet për të cilat një faturë e shitjes është lëshuar duhet të futet në librin e shitjeve brenda 3 ditëve pas lëshimit të faturës së shitjes.

E saktë

E pasaktë

10. Sipas ligjit të Tvsh-së bizneset e huaja duhet të regjistrohen në regjistrin e detyrueshëm të Tvsh-së nga momenti i fillimit të aktivitetit të tyre në territorin e Kosovës.

E saktë

E pasaktë

11. Sipas dispozitave te ligjit nr. 03/L-162 Për Tatimin ne te Ardhurat e Korporatave shkalla ne përqindje e pagesës se tatimit për kompanitë qe paguajnë mbi fitimin real dhe kompanitë qe paguajnë mbi qarkullimin vjetore te tyre eshte;10% mbi fitimin real; 9% e primit bruto për sigurimet dhe risigurimet; 3% ne qarkullim per biznese me qarkullim nga 0 – 50,000 EUR por jo me pake se 37.5 Euro.

E saktë

E pasaktë

12. Sipas ligjit të Tvsh-së, personi i tatueshëm mund të kërkojë rimbursimin e TVSh-së nëse për tre (3) muaj radhazi është në kreditim dhe në fund të muajit të tretë shuma e kreditimit të TVSh-së kalon vlerën prej njëmijë euro (1,000 €), si dhe nëse janë dorëzuar të gjitha deklaratat e TVSh-së dhe tatimeve tjera për të gjitha periudhat tatimore të kaluara.

E saktë

E pasaktë

13. Sipas dispozitave te ligjit nr. 03/L-162 për Tatimin ne te Ardhurat e Korporatave, shpenzimet për përmirësimin e pronave me qira të cilat përdoren për veprimtari ekonomike të tatimpaguesit do të kompensohen përmes zbritjeve të zhvlerësimit të llogaritura me metodën lineare për periodën e kohëzgjatjes së qirasë.

E saktë

E pasaktë

14. Sipas Ligji per Fondet Pensionale, kontributet e dhëna nga një punëdhënës në FKPK në të mirë të punonjësve të tij do të konsiderohen një shpenzim operativ dhe përkatësisht do të zvogëlojë rezultatin operativ te punëdhënësit për qëllim të taksave.

E saktë

E pasaktë

15. Sipas Ligjit të Punës, Kontrata e Punës mund të lidhet për një periudhë të pacaktuar, një periudhë të caktuar; si dhe punë dhe detyra specifike.

E saktë

E pasaktë

16. Sipas Ligjit të Punës, në rast të ndërrimit statusor, përkatësisht të ndërrimit të punëdhënësit, punëdhënësi i ardhshëm nga punëdhënësi paraprak në përputhje me Kontratën Kolektive dhe kontratat e punës, nuk i merr përsipër detyrimet dhe përgjegjësitë nga marrëdhënia e punës të cilat janë të aplikueshme në ditën e ndërrimit të punëdhënësit.

E saktë

E pasaktë

17. Sipas Ligjit nr. 05/L-028 Për Tatimin në të Ardhurat Personale, periudha tatimore për bizneset individuale që kanë një qarkullim nën 50,000 Euro dhe që nuk janë të regjistruar në fitimin real, është çdo tremujorësh.

E saktë

E pasaktë

18. Sipas ligjit nr. 06/L-105 Për Tatimin ne te Ardhurat e Korporatave, një tatimpagues me të ardhura vjetore bruto prej 30.000 Euro apo më pak për te zgjedhur që të përgatitin pasqyrat financiare dhe te paguaj tatim ne fitimin real duhet të dorëzojë një kërkesë për regjistrim në ATK, deri më 31 Mars të vitit aktual për të cilin tatimpaguesi kërkon te regjistrohet.

E saktë

E pasaktë

19. Sipas ligjit nr. 06/L-105 Për Tatimin ne te Ardhurat e Korporatave, çdo humbje nga shitja apo këmbimi i pasurisë në mes të personave të lidhur konsiderohet shpenzim i zbritshëm.

E saktë

E pasaktë

20. Sipas Ligjit te Tvsh një biznes me rastin e përlllogaritjes së pragut për regjistrim në Tvsh, personi duhet të marrë parasysh shumën totale të të gjitha furnizimeve të tija përgjatë periudhës së 12 muajve të fundit dhe kjo shume te jete mbi 30,000 Euro.

E saktë

E pasaktë

Pjesa C. Pyetjet problemore

Problemi 1

15 pikë

Kompania OLTA shpk me seli në Prishtinë kryen disa aktivitete ekonomike dhe gjatë muajit Tetor 2020 ka këto transaksione: shitjet brenda vendit me norme 18% - shuma e tatushme 102,000 Euro, shërbime transportit Prishtinë - Tiranë 33,800 Euro, blerjet nga bizneset të cilat nuk janë të regjistruar në Tvsh 10,200 Euro, import nga Franca (kamion) i cili shërben për aktivitetin e transportit, vlera e faturës me shpenzime përcjellëse 15,000 Euro, (pasuri që i nënshtrohet doganës 10%), blerje e një veture në vlerë të kostos prej 40,000 Euro nga një biznes vendor me norme 18% i cili konsiderohet si veturë luksi (vlerësimet fillestare janë që do të zhfrytëzohet 50% për qëllime biznesi), shpenzimet e zhvlerësimit mujor janë llogaritur në vlerë 3,800 Euro, notë kreditore e lëshuar me normë 18% vlera 2,000 Euro shuma e tatushme, shpenzime të rrymes ujit etj të cilat i nënshtrohen normës së reduktuar 1,600 Euro (shuma e tatushme). Gjatë këtij muaji ka paguar paga neto në vlerë prej 6,500 Euro.

Blerjet vendore me normë statndarde të këtij muaji kanë qenë në vlerë prej 42,000 Euro, 60% e të cilave kanë qenë blerje e mallit tregtar për rishitje. Gjithashtu kanë qenë edhe dy(2) importet të rregullta (IM4), mall tregtarë për rishitje, në vlerë 20,000 Euro (përfshirë shpenzimet e transportit 1,200 Euro).

Poashtu gjatë këtij muaji ka pranuar shërbime të nga jashtë vendit në vlerë prej 2,500 Euro (ngarkesë e kundërt).

Vlerat e paraqitura janë pa përfshire Tvsh-në. Biznesi në fjalë ka trashëguar një obligim të muajit Shtator 2020 në vlerë prej 1,400 Euro.

Kërkesa:

Përpiloni ekstraktin e deklaratës së Tvsh-së sipas renditjes se sa ka pagesë/kreditim për muajin 10/2020.

Zgjidhje: Ekstrakt i deklaratës mujore Tetor 2020:

[TV] FORMULARI I DEKLARIMIT TË TVSH			
Periudha e Deklarimit:	Kolona [1]	10	2020
Numri Fiskal:	Kolona [3]	600700800	
Emri i biznesit:	Kolona [4]	OLTA shpk	
Adresa e biznesit:	Kolona [5]	PRISHTINË, KOSOVË	
Emri i personit kontaktues dhe telefoni:	Kolona [6]	Fistek Filani 044/123123	

Furnizimet Vlera			TVSH
Shitjet e liruara pa të drejtë kreditimi	Kolona [9]	-	
Shitjet e liruara me të drejtë kreditimi	Kolona [10]	33,800	
Shitjet e tatueshme me normën 18%	Kolona [12]	102,000	18,360
Blerjet që i nënshtrohen ngarkeses së kundërt	Kolona [28]	2,500	450
		Kolona [30]	18,810

Blerjet Vlera			TVSH
Blerjet dhe importet pa TVSH	Kolona [31]	10,200	
Blerjet dhe importet investive me TVSH jo të zbritshme	Kolona [34]	23,600	
Importet me normë 18%	Kolona [35]	20,000	3,600
Importet investive me normë 18%	Kolona [39]	16,500	2,970
Blerjet vendore me normë 18%	Kolona [43]	42,000	7,560
Blerjet vendore me normë 8%	Kolona [45]	1,600	128
Blerjet investive vendore me normë 18%	Kolona [47]	20,000	3,600
Nota debitore e pranuar, nota kreditore e lëshuar me normë 18%	Kolona [53]	2,000	360
E drejta e kreditimit të TVSH-së në lidhje me ngarkesën e kundërt me normë 18%	Kolona [65]	2,500	450
		Kolona [67]	18,668

Kalkulimi Vlera			
Teprica a TVSH-së e bartur nga muaji i kaluar	Kolona [68]	-	
Balanca kreditore e mbetur 69 = ((67+68)-30)>0	Kolona [69]	-	
Kërkesa për rimbursim	Kolona [70]	-	
Kreditimi i tvsh-së per muajin pasues 71 =(69-70)	Kolona [71]	-	
TVSH që duhet të paguhet 72 =(30-67-68)>0	Kolona [72]	142	

Sqarim: Blerjet dhe importet me Tvsh jo të zbritshme :

$$\begin{aligned}
 &(40,000 \times 50\%) = 20,000 \text{ (pjesa e kostos)} \\
 &\text{plus(+)} 40,000 \times 50\% \times 18\% = 3,600 \text{ (pjesa e Tvsh-së së pazbritshme)} \\
 &\text{Total} = 23,600
 \end{aligned}$$

$$\begin{aligned}
 &\text{Blerjet investive vendore me normë 18\%: } 40,000 \times 50\% = 20,000 \\
 &\text{Importet investive me normë 18\%: } 15,000 + 10\% = 16,500
 \end{aligned}$$

Problemi 2**10 pikë**

Kompania VESA shpk me seli në Prishtinë, e regjistruar me Tvsh ka prezantuar informatat në vijim sa i përket aktivitetit të saj afarist për 6 mujorin e parë të vitit:

- Shitjet e tatueshme kesh : 112,000 Euro (përfshirë Tvsh 18%)
- Shitjet e tatueshme me afat :65,000 Euro (përfshirë Tvsh 18%)
- Shpenzimet bankare :2,800 Euro
- Pagat :31,200 euro (përfshirë KP të punëdhënësit)
- Blerjet vendore (mall tregtar) : 35,000 euro (përfshirë Tvsh 18%)
- Shp. e zhvleresimit : 9,200 euro
- Stoqet në fillim të vitit :30,380 euro (me kosto)
- Tërheqjet nga pronari :6,000 euro (kesh)
- Shpenzime familjare nga pronari të paguara me kartelë të biznesit 1,500 euro.
- Stoqet në fund te vitit :36,030 euro (me kosto)
- Shpenzimet tjera me fature (përfshirë Tvsh 18%) : 13,233.35 euro
- Shpenzimet tjera me fature (pa Tvsh) : 3,919 euro
- Importe te rregullta IM4 (mall tregtar) : 60,167 (përfshirë Tvsh 18%)

Norma e tatimit në fitim është 10%.

Kërkohet:

- a) Të përpilohet pasqyra e të ardhurave sipas ligjit TAK ? **8 pikë**
- b) Sa është marzha Bruto dhe Neto mbi shitjet për periudhën e vitit ? **2 pikë**

Zgjidhje:

		Sqarimet:
Shitjet totale (kesh dhe me afat)	150,000	<-- (112,000+65,000)/1.18)
KMSH		
Stoqet në fillim	30,380	
+Blerjet vendore dhe importet e mallit tregtar	80,650	<--- (35,000+60,167/1.18)
-Stoqet në fund	36,030	
	<u>(75,000)</u>	
Fitimi Bruto	75,000	
Shpenzimet e pagave	(31,200)	
Shpenzimet e zhvleresimit	(9,200)	
Shpenzime bankare	(2,800)	
Shpenzimet tjera (me TVSH)	(11,215)	<--- (13,233.35/1.18)
Shpenzimet tjera (pa TVSH)	<u>(3,919)</u>	
Fitimi para tatimit	16,667	
Tatimi @10%	<u>(1,667)</u>	
Fitimi Neto	15,000	

Marzha bruto mbi shitjet: $150,000/75,000= 50\%$

Marzha neto mbi shitjet: $15,000/150,000= 10\%$

Kompania KLERTI shpk më datë 31.12.2019 kishte ketë shpenzim të zhvlerësimit sipas kontabilitetit:

- Grupi I - 6,500
- Grupi II - 6,000
- Grupi III - 18,000

Për grupin e parë kompania kishte një politike të zhvlerësimit 15% në vit, për grupin e dytë 10%, për grupin e tretë 8%. Kompania me 1 tetor të vitit 2019 kishte blerë një aset të grupit të tretë në vlerë prej 48,000 Euro (zhvlerësuar sipas muajit për qëllime kontabël). Të gjitha asetet tjera janë blerë gjatë vitit 2017.

Kërkohe:

a) Llogaritni ndryshimin e zhvlerësimit në mes të kontabilitetit financiar dhe kontabilitetit të tatimeve sipas grupeve?

Zgjidhje:

Grupi I

Kontabiliteti	$43,333.33 \times 15\% = 6,500.00$
Tatimet	$43,333.33 \times 5\% = 2,166.66$
Δ Rritje e shpe. të zhvlerësimit	4,333.34

Sqarim: $6,500 / 15\% = 43,333.33$

Grupi II

Kontabiliteti	$60,000 \times 10\% = 6,000$
Tatimet	$60,000 \times 20\% = 12,000$
Δ Zvogelim i shpe. të zhvlerësimit	6,000

Sqarim: $6,000 / 10\% = 60,000$

Grupi III

Kontabiliteti aset i ri	$(48,000 \times 8\% = 3,840 / 12 \times 3) = 960$
Kontabiliteti	$213,000 \times 8\% = 17,040$
Total sipas Kontabiliteti	18,000
Tatimet aset i ri	$48,000 \times 10\% / 2 = 2,400$
Tatimet	$213,000 \times 10\% = 21,300$
Totali sipas Tatimeve	23,700
Δ Zvogëlim i shp. të zhvlerësimit (23,700-18,000)	5,700

Sqarim: $18,000 - 960 = 17,040$

$17,040 / 8\% = 213,000$

Kompani "CLOSE" shpk me rastin e mbylljes së aktivitetit ekonomik në Janar 2020, ka në posedim:

- 1) Stoque në vlerë prej 2,000 Euro për të cilat ka paguar 360.00 Euro Tvsh prej 18% me rastin e blerjes;
- 2) Mjet transportues i blerë në vitin 2008 në vlerë 12,000 Euro plus 15% Tvsh në vlerë 1,800 Euro;
- 3) Makineri prodhimi e blerë në vitin 2019 në vlerë 10,000 Euro plus 18% Tvsh në vlerë 1,800 Euro;
- 4) Lokal afarist të ndërtuar në vitin 2006 në vlerë prej 50,000 Euro plus 15% Tvsh në vlerë 7,500 Euro;

Këto mallra/pasuri nuk ka mundur t'i shes prandaj ka vendosur t'i përvetësoj pronari i kompanisë "CLOSE" shpk.

Kërkesa:

Si duhet të jetë trajtimi për Tvsh në deklaratën e kompanisë "CLOSE" shpk për periudhen Janar 2020?

Zgjidhje:

1) Për Stocet duhet deklaruar si shitje në vlerë prej 2,000 Euro plus 18% Tvsh në vlerë 360 Euro.

2) Për Mjetin transportues, meqenëse ka kaluar periudhë më e gjatë se 5 vite kalendarike nga blerja e tij, nuk kërkohet të bëhet rregullim për Tvsh në deklaratën e muajit Janar 2020.

3) Për Makineri prodhimi, meqenëse është shfrytëzuar vetëm për një vit, rregullimi për Tvsh duhet të bëhet edhe për 4 vite.
 $1,800/5 = 360 \text{ Euro} \times 4 \text{ vite} = 1,440 \text{ Euro}$. Pra, duhet të bëhet rregullimi për të ulur Tvsh-në e zbritshme në vlerë prej 1,440 Euro.

4) Për Lokalin afarist meqenëse është shfrytëzuar vetëm për 14 vite, rregullimi për Tvsh duhet të bëhet edhe për 6 vite.
 $7,500/20 = 375 \text{ Euro} \times 6 \text{ vite} = 2,250 \text{ Euro}$. Pra, duhet të bëhet rregullimi për të ulur Tvsh-në e zbritshme në vlerë prej 2,250 Euro.

Kompania JONI Co shpk ka të punësuar një punëtorë dhe një menaxher. Paga e të punësuarve për muajin Nëntor 2020 janë si me poshtë:

Menaxheri 800 Paga Neto
 Punëtori 800 Paga Bruto

Kërkohe:

Llogaritni detyrimin e tatimit në paga dhe kontributin pensional (KP) për muajin Nëntor 2020 të këtyre të punësuarve (Kujdes pagat janë **neto/bruto**).

Zgjidhje:

1. Menaxheri: paga Nëntor = 800 Neto

	a	b	c=axb	d=a-c	
	Paga e tatueshme	Shkalla e tat.	Tatimi	Paga Neto	Kumulative Paga Neto
1.	80	0%	0	80.00	80.00
2. (1*)	170	4%	6.80	163.20	143.20
3. (2*)	200	8%	16.00	184.00	427.20
4.(3*)	414.22	10%	41.42	372.80 (3*)	800.00
TOTAL	864.22		64.22	800.00	

KP:

Paga bruto $864.22/95\% = 909.71$

KP = $909.71 \times 5\% = 45.49 + 45.49 = 90.98$

(1*) diferenca e pages nga 80 - 250 = 170

(2*) diferenca e pages nga 250 - 450 = 200

(3*) diferenca e pages neto $80+163.20 +184= 427.20$

Paga neto e menaxherit $800 - 427.20 = 372.80/90\% = 414.22$

2. Punëtor: paga Nëntor = 800 Bruto

KP = 800 x 5% = 40 + 40 = 80.00

(*)Paga e tatueshme 800-40=760.00

	Rangu	% e tatimit	Tatimi
Niveli 1	0 - 80	0%	0.00
Niveli 2	80 - 250	4%	6.80
Niveli 3	250 - 450	8%	16.00
Niveli 4	450 - 760 (*)	10%	31.00
TOTAL			53.80

Paga neto: 760.00-53.80 = 706.20

	Paga Bruto	Tatimi	Pensioni	Pensioni	Paga Neto
Menagjeri	909.71	64.22	45.49	45.49	800.00
Punetori 1	800.00	53.80	40.00	40.00	706.20
TOTAL	1,709.71	118.02	85.49	85.49	1,506.20

Kompania KLERTI partners shpk gjatë muajit Nëntor 2020 ka pasur tri pasuri objekte/lokale të marra me qira me kontratë me pagesa mujore:

- 1) Zyre qendrore me qira neto 750,00 Euro si dhe
- 2) Depo e mallit me qira bruto 750.00 Euro.
- 3) Dyqani me qira në vlerë 500.00 Euro përfshirë Tvsh-në.

Vlerat përkatëse të qirasë janë paguar gjatë muajit Nëntor 2020.

Kërkoet:

Të kalkulohet tatimi i mbajtur në burim (pjesa e qirasë) për muajin Nëntor 2020?

Zgjidhje:

Zyre: 750 Euro neto => 824.18 bruto (bazë për kalkulim)

Depo: 750 Euro bruto (bazë për kalkulim)

Dyqani: $500/1.18 = 423.72$ Euro bruto (bazë për kalkulim)

Total bruto = $824.18+750+423.72= 1,997.90$

Tatimi i mbajtur në burim : $1,997.90 \times 9\% = 179.81$